

Vendim nr. 311 datë 18.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marjana Semini, Anëtare
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 18.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: KUJTIM DOKU

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2741 (283), datë 27.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja “e”, 50, pika 4, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Kujtim Doku ka shërbyer si oficer aktiv në strukturat e Forcave të Armatosura, deri kur është nxjerrë në rezervë, duke përfituar pagesë kalimtare për një periudhë dyvjeçare. Në vazhdim, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, kërkuesi është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

2. Për shkak të parashikimeve të reja ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore, të miratuara në vitin 2009 (*Ligji për pensionin e vitit 2009*), Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Tiranë ka rilogaritur masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke i njohur kërkuesit masën përfundimtare nga data 01.07.2009. Llogaritja e masës së pensionit është bërë objekt kundërshtimi në gjykatë nga kërkuesi.

3. Në përfundim të gjykimit në gjykatat e faktit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1842, datë 09.09.2015, ka vendosur, ndër të tjera, detyrimin e DRSSH-së, Tiranë që t'i paguajë kërkuesit shumën prej 597.477 lekësh, si diferenca të papaguara të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën 01.01.1999 - 30.06.2009.

4. Ndonëse palët në proces kanë paraqitur rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1625, datë 14.07.2022, ka vendosur mospranimin me arsyen se nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit për mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi.

5. Në datën 11.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të dhëna për çështjen e tij. Kërkesa është pranuar pjesërisht nga Gjykata, e cila, me vendimin nr. 23, datë 25.04.2023 (*vendimi nr. 23/2023*), ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1625, datë 14.07.2022 të Gjykatës së Lartë dhe ka dërguar çështjen për rishqyrtim po në atë gjykatë.

6. Pas rishqyrtimit të çështjes, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2741 (283), datë 27.06.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1842, datë 09.09.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me argumentin që gjykata e apelit të hetojë pretendimet e kërkuesit në drejtim të konkluzionit të arritur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 (*vendimi unifikues nr. 3/2016*), lidhur me ligjin e zbatueshëm dhe mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm të ushtarakut.

7. Në datën 25.10.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 11.11.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

- 8.1. *Parimin e shtetit të së drejtës në drejtim të sundimit të ligjit dhe mënjanimit të arbitraritetit*, pasi nga zbatimi i ligjit të vitit 2009, masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të njohur dhe caktuar më parë është zvogëluar me 15 027 lekë, duke u bërë nga 25 564 lekë në 10 537 lekë. Dhunimi i sundimit dhe arbitrariteti për ligjin shprehet edhe nga Gjykata në dy vendimet e saj nr. 33, datë 24.06.2010 (*vendimi nr. 33/2010*) dhe nr. 2, datë 18.02.2013 (*vendimi nr. 2/2013*), sipas të cilave skema e pensionit nuk duhet të përkeqësojë ndjeshëm jetesën e shtetasve që e përfitojnë atë dhe se zvogëlimi i pensionit nuk mund të përlligjet me interesat e rëndësishëm publikë.
- 8.2. *Rendin juridik dhe hierarkinë e burimit të së drejtës së fituar*, për sa i takon pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën e përcaktuar nga ligji, në kushtet kur masa e tij zvogëlohet ndjeshëm, pasi për 23 vjet vjetërsi shërbimi, nga data 01.01.1999 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie në datën 13.02.2016, masa e pensionit deri në datën 30.06.2009 bëhet 8 000 lekë e indeksuar me 4 082 lekë më pak në muaj dhe nga data 01.07.2009 zvogëlohet me 15 027 lekë më pak në muaj të indeksuar.
- 8.3. *Parimin e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën me të cilën lindi e drejta*, pasi Gjykata e Lartë nuk respekton përcaktimet ligjore të kohës që kanë rregulluar masën e pensionit për periudhat nga data 01.01.1999 dhe nga data 14.05.2005 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie në datën 13.02.2016, kurse referimi te vendimi unifikues nr. 3/2016 zvogëlon ndjeshëm masën e pensionit.
- 8.4. *Parimin e sigurisë juridike të së drejtës së fituar* për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me ligjet e viteve 1991 dhe 2004, pasi me kthimin e çështjes për rishqyrtim, bazuar në përfundimet e vendimit unifikues nr. 3/2016, masa e pensionit nuk duhet të kalojë masën maksimale të pensionit të pleqërisë, gjë e cila passjell uljen

e masës së pensionit të tij. Ligjet e viteve në fjalë kanë garantuar masën e pensionit nga datat 01.01.1999 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie në masën 50% të pagës referuese për 15 vjet vjetërsi, duke i shtuar 2% të kësaj page për çdo vit tjetër shërbimi mbi 15 vjet. Interpretimi i Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 3/2016 bie në kundërshtim me interpretimin pajtues të Gjykatës në vendimin nr. 33/2010, sipas të cilit rillogaritja e pensionit bëhet vetëm nëse masa sjell pasoja pozitive.

- 8.5. *Parimin e ndalimit të fuqisë prapavepruese*, pasi nga zbatimi i ligjit të vitit 2009 rillogaritet pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi edhe kur masa e tij zvogëlohet, ndërkohë që ai duhet të gjejë zbatim vetëm nëse masa e pensionit rritet. Këtë interpretim e qartëson edhe vendimi nr. 33/2010 i Gjykatës. Ndaj rivendosja e së drejtës nëpërmjet rillogaritjes së masës së pensionit, sipas vendimit nr. 33/2010 të Gjykatës, realizohet vetëm nëpërmjet shfuqizimit të vendimeve objekt kundërshtimi.
- 8.6. *Zbatimin e detyrueshëm të vendimmarrjes së Gjykatës të viteve 2007, 2010 dhe 2013*, të cilat nuk lejojnë rillogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi nëse ai pëson zvogëlim. Në rastin e tij, nga ndryshimi i bërë në zbatim të rillogaritjes sipas ligjit të vitit 2009, masa e pensionit që përfitonte në datën 30.06.2009 u zvogëlua me 14 988 lekë më pak në muaj nga data 01.07.2009, deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, datë 13.02.2016. Vendimet objekt kundërshtimi i kanë kufizuar deri në cenim të drejtën e fituar me ligjet e mëparshme deri në datën 30.06.2009 dhe nga data 01.07.2009 e në vazhdim deri në pension pleqërie.
- 8.7. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, arsyetimit të vendimit dhe të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi vendimi nr. 23/2023 i Gjykatës është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, pas 1 viti e 1 muaj nga data e regjistrimit të çështjes, përtej afatit ligjor prej 90 ditësh. Po kështu, Gjykata e Lartë edhe pas rishqyrtimit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet

të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka rishqyrtuar çështjen e tij, në përmbushje të detyrimit të disponuar nga Gjykata me vendimin e saj nr. 23/2023, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i takon kriterit për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka theksuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion subsidiar, ndaj mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor. Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës, duke i parashtruar asaj dy kërtime në objekt: (i) shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2024-2741 (283), datë 27.06.2024, i cili ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1842, datë 09.09.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues; (ii) shfuqizimin e vendimit unifikues nr. 3/2016, i cili ka unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje me mënyrën se si do të zbatohen dispozitat e ligjit të vitit 2009 për llogaritjen e masës së pensionit të parakohshëm për disa kategori funksionesh.

13. Lidhur me kërkimin e parë, për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji evidenton se vendimet gjyqësore që kthejnë çështjen për rigjykim nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimin nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në kushtet kur procedurat gjyqësore për

shqyrtimin në themel të çështjes nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kërkuessit ka ende mjete ligjore në dispozicion për të paraqitur pretendimet e tij përpara atyre gjykatave dhe eventualisht, në përfundim të gjykimit, edhe pranë Gjykatës.

14. Për sa i përket kërimit të dytë, për shfuqizimin e vendimit unifikues nr. 3/2016 të Gjykatës së Lartë, kërkuessi e ka ngritur këtë kërkim për shkak të arsytimit që Gjykata e Lartë i ka bërë çështjes së tij kur ka vendosur hetimin nga gjykata e apelit të pretendimeve në raport me vendimin unifikues lidhur me ligjin e zbatueshëm dhe mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm. Në analizë të argumenteve të kërkuessit, Kolegji vëren se kërkitimi, në thelb, ka të bëjë me unifikimin e praktikës gjyqësore prej Gjykatës së Lartë të kuptimit të ligjit të zbatueshëm në çështje të ngjashme me atë të kërkuessit. Në këtë mënyrë, kërkitimi për ligjin e zbatueshëm është i lidhur me themelin e çështjes së kërkuessit, që është ende në proces gjykimi në gjykatën e apelit pa një vendim përfundimtar. Për këtë arsye, edhe ky kërkitimi nuk mund të merret në shqyrtim, pasi nuk janë shteruar ende mjetet juridike në dispozicion.

15. Gjithashtu, Kolegji vëren se kërkuessi ka parashtruar në ankimin e tij edhe argumente për shkeljen e së drejtës për gjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë brenda një afati të arsyeshëm. Sipas kërkuessit, Gjykata e Lartë e ka rishqyrtuar rekursin pas kthimit të çështjes nga Gjykata me vendimin nr. 23/2023, pas 1 viti e 1 muaj nga data e regjistrimit të saj, pra përtej afatit ligjor prej 90 ditësh. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji sjell në vëmendje se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile (KPC) me ligjin nr. 38/2017, ku është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se këto mjete ligjore për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërkohë, në rastin konkret, nuk rezulton që gjatë rishqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë kërkuessi të ketë përdorur këto mjete ligjore të parashikuara nga *nenet 399/1* e vijues të KPC-së për të mbrojtur të drejtën kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, për rrjedhojë ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

16. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuessi nuk ka shteruar plotësisht mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet gjykimit kushtetues. Në kushtet kur ky kriter

paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.